



Pranuar / Dorezuar Prilimjen/Prilato Received/Delivery	26.08.2022	viti god year	2
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK	5000/2022		114



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova  
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.589/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër Anr.589/2022 të datës 01.07.2022 të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_ përmes postës elektronike E-maili:

kundër organit të punësit Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike “masë disiplinore-vërejtje me shkrim”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.08.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa numër A.nr.589/2022 e datës 01.07.2022 e parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_
- II. ANULOHET Vërejtja me shkrim me numër protokollit 18583 i datës 16.06.2022 e nxjerrë nga Drejtorja e Departamentit për Financa dhe Buxhet në Komunë të Kamenicës, si dhe të gjitha vendimet tjera që rrjedhin nga kjo vërejtje.
- III. OBLIGOHET Kryetari dhe Udhëheqësi i Personelit i Komunës së Kamenicës, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankueses në pajtim me këtë vendim.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ndaj ankueses \_\_\_\_\_ e punësuar në Komunën e Kamenicës, sipas Akt emërimit të datës 04.12.2019 me numër protokollit 3763 në vendin e punës “Zyrtare për buxhet dhe financa” në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, me datë 16.04.2022, Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunë të Kamenicës i ka shqiptuar “vërejtje me shkrim”, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses, me dyshimin se ankuesja ka bërë shkelje të lehtë disiplinore të



përcaktuara në rregullat e etikës dhe sjellje të pahijshme gjatë kohës së punës në raport me mbikëqyrësin e saj, në bazë të nenit 46 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Kundër Vërejtjes me shkrim të datës 16.06.2022 me nr. protokolli 18583, ankuesja ka parashtrua ankesë me datë 01.07.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e regjistruar me numër A.nr.589/20221, përmes postës elektronike E-mailit: \_\_\_\_\_ në adresën elektronike të Këshillit: \_\_\_\_\_ me pretendime ankimore se vërejtja me shkrim i është shqiptuar pa bazë ligjore dhe pa vërtetuar gjendjen faktike dhe juridike, duke propozuar që ti aprovohet ankesa dhe të anulohet vërejtja e datës 16.06.2022 .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 07.07.2022 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek në Komuna e Kamenicës. Me datë 27.07.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga në Komuna e Kamenicës, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.08.2022 ka nxjerr Vendim me numër VK.Nr.80/2022 për zgjatjen e afatit për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) ditë pune, për ankesën me numër A.nr.589/2022 të datës 01.07.2022.

**Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova:** Ankesë Anr.589/2022 me numër protokolli 3856/2022 të datës 01.07.2022 (E-mail) e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i datës 04.12.2019 me numër protokolli 37632; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë viti 2019; Vendimit nr.protokolli 12844 të datë 14.04.2021 për Formimin e komisionit disiplinor; Vendimi nr.protokolli 23999 i datë 16.08.2021 për shfuqizimin e vendimit nr.02/13123 të datës 17.03.2017 për formimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve në lëminë e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale; Vendimit nr.protokolli 18764 i datë 07.07.2021 për formimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për fëmijët e porsalindur; Vendimi nr.protokolli 18699 i datë 28.08.2020 për punë shtesë; Vërejtje me shkrim e datës 16.06.2022 nr.protokolli 18583; Përgjigje në kërkesë e datës 27.07.2022; E-mail i datës 22.07.2022 nga z.A.D për z.P.V për konfirmim; Përgjigjen E-mail , i datës 22.07.2022 lidhur me konfirmimin nga z.P.V për z. A.D.; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021; Vendim me numër VK.Nr.80/2022 te datës 15.08.2022 të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuseses *është e bazuar, sepse:*

Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunë të Kamenicës me datë 16.06.2022 i ka shqiptuar masë disiplinore-vërejtje me shkrim, ankuseses \_\_\_\_\_ e cila mban pozitën "Zyrtare për buxhet dhe financa" në Sektorin për Buxhet dhe Financa në Komunë të Kamenicës, nen dyshimin e bazuar se e njëjta e ka ofenduar Drejtoreshën dhe se me veprimet e saj ka kryer shkelje të rregullave të etikës konkretisht shkelje te lehta të detyrave dhe përgjegjësive të punës, sjellje të pahijshme gjatë kohës së punës në raport me mbikëqyrësin e saj sipas nenit 46 paragrafin 1 dhe 2 nën paragrafin 2.2 paragrafin 4 nën paragrafi 4.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe dispozitat e Rregullores (QRK)Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e



Zyrtarëve Publik. Po ashtu Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunë të Kamenicës pasi që ka nxjerrë vërejtjen me shkrim të datës 16.06.2022 me nr.protokolli 18583, me datës 22.07.2022 ka kërkuar konfirmim me shkrim (*Email zyrtar*, në ora 11:13) nga vartësi i saj përkatësisht nga Zyrtari për Zotim të Mjeteve Buxhetore, në Drejtorin për Financa dhe Buxhet në Komunë të Kamenicës, se a ka pasur ofendim në formë verbale nga ana e ankueses apo jo, i cili po përmes emailit me datë 22.07.2022 në ora 11:30 i përgjigjet dhe i thotë se *"ka ndodhë një fjalë jo e këndshme..."*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se shqiptimi i masës disiplinore "vërejtje me shkrim", me datë 16.04.2022 nga Drejtoresha e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunë të Kamenicës me numer protokollit 18583, i është shqiptuar pa vërtetuar bazën ligjore dhe pa vërtetuar gjendjen faktike dhe juridike, e cila thekson se është nxjerrë në kundërshtim me Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Rregullores (QRK)Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, dhe të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe i propozon Këshillit që ti aprovohet ankesa dhe të anulohet vërejtja e datës 16.06.2022 e shqiptuar si e paligjshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me qëllim të vendimmarrjes në mënyrë sa më të drejtë më datë 16.08.2022 ka kërkuar prova shtesë tek Menaxheri i Personelit në Komunën e Kamenicës, me sqarim – se kush është mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses, ndërsa përmes emailit të datës 18.08.2022 në përgjigjen elektronike E-mailit zyrtar, ka sqaruar duke deklaruar se, citoj: *"Në lidhje me pyetjen tuaj po mundohemi të japim këtë përgjigje: ne sistemin e SIMBNJ mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i drejtorisë për buxhet dhe financa është drejtoresha znj Zyrtarja rregullisht i raporton si dhe vlerësohet nga Zyrtari i Lar. por konform katalogut të vendeve të punës si dhe rregullores për klasifikimin e vendeve të punës nuk e ka këtë kompetence..... me Akt-Emërim, është udhëheqës i sektorit (sipas mendimit tonë konsiderojmë që i njëjti duhej të ishte edhe mbikëqyrës i drejtpërdrejtë), por i njëjti me vendim konform ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nga Kryetari i Komunës, është autorizuar që ti kryen punët dhe detyrat si Zyrtarit Kryesor Financiar"*, që në fakt në bazë të deklaratimit të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Kamenicës dhe në bazë të provave të bashkangjitura në përgjigje, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se, ankuesja nuk e ka mbikëqyrës të drejtpërdrejtë e cila edhe pse është në pozitë Drejtoreshë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa të njëjtës nuk i raporton, andaj lidhur me këtë është vërtetuar se cili mbanë pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Buxhet dhe Financa", në Komunë të Kamenicës është mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankueses.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht kapitullin IV, lidhur me Disiplinën në Shërbim Civilë, si dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me të cilën është rregulluar në mënyrë specifike procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civil. Ndërsa në kuptim të kompetencës për iniciimin e procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masave disiplinore, Kolegji ju referua nenit 47 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *1.Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil, ndërlidhur me këtë neni 48 paragrafi 1 i po këtij ligji ka*



përcaktuar se: *1.Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë*", e mbi këtë bazë ligjore rrjedh se Drejtoresha e DFB-së në Komunën e Kamenicës nuk ka pasur kompetencë për të shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore "*vërejtje me shkrim*", sepse në bazë të provave materiale nuk është mbikëqyrëse e drejtpërdrejt e ankueses.

Meqenëse një akt administrativ i nxjerrë nga organi i cili nuk ka pasur kompetencë konsiderohet akt i paligjshëm sipas nenit 52 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nuk u lëshua në konstatimet e ligjshmërisë materiale të pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë.

Si u tha më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se obligohet Kryetari dhe Udhëheqësi i Personelit i Komunës së Kamenicës, që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të bëjnë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me këtë vendim.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në diapozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nën 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.589/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

MALSORE GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunes se Kamenicës;
- Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunë të Kamenicës,
- Arkivit të KPMSHCK-së.